# KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot, me date 20.09.2023 (Njezet shtator Njezet njezetetre) nenshkruhet kjo kontrate mes paleve:

Znj. Joana Karaj, shtetase shqiptare, lindur me 11.04.1990 ne Tirane e banuese ne Tirane, mbajtese e pasaportesh me nr. BJ0708632 dhe nr. personal J05411051O, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar;

*(ne vijim referuar si "Shitesi")*

*dhe*

Z. Astrit Xhebrahimi, shtetase shqiptare, lindur me 17.07.1977 ne Tirane e banuese ne Tirane, mbajtese e pasaportesh me nr. BD1151398 dhe nr. personal H70717144C, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar;

*(ne vijim referuar si "Bleresi")*

Ne vijim e per efekt te kesaj Kontrate, Shitesi dhe Bleresi do te referohen vecmas si Pale/a dhe se bashku si Pale/t.

MEQENESE:

A. Shoqeria " Green Nature 17" Sh.P.K., eshte nje shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar e krijuar e qe funksionon ne perputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit me Numer Unik Identifikimi L82121017K, me kapital themeltar 2.000.000,00 Leke, te zoteruara ne masen 100% nga Ortaku Joana Karaj (me poshte referuar *"Shoqeria")*.
B. Shitesi deshiron te transferoje 100% te kapitalit te zoteruar prej tij ne Shoqeri dhe Bleresi ka pranuar te bleje 100% te kapitalit te zoteruar dhe te ofruar nga Shitesi ne Shoqeri;
C. Ne zbatim te kerkesave te Statutit te Shoqerise, Palet kane vendosur te lidhin kete Kontrate;

ATEHERE, duke qene se ekzistojne keto kushte paraprake, per te cilat Palet nuk kane pretendime apo kundershtime.Palet bien dakord per sa me poshte vijon:

Neni 1 Objekti

1.1 Nepermjet kesaj Kontrate Shitesi i shet Bleresit 100% te kapitalit te zoteruar prej tij ne Shoqeri dhe Bleresi bien nga Shitesi 100 % te kapitalit te zoteruar nga Shitesi ne kapitalin themeltar te Shoqerise " Green Nature 17" Sh.P.K., shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar, e regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me Numer Unik Identifikimi NUIS L82121017K.

Neni2 Çmimi

2.1 Cmimi i shitjes se 100% (njeqind perqind) te kapitalit te zoteruar nga Shitesi ne shoqeri eshte 100.000 LEKE (njeqind mije leke).
2.2 Cmimi i siperpermendur i shitjes eshte paguar teresisht nga bleresi tek shitesi para nenshkrimit te kontrates, dhe palet konfirmojne se nuk kane pretendime ne lidhje me cmimin e shitjes dhe menyren e pageses.

Neni3 Deklarimet dhe garancite

3.1 Shitesi deklaron dhe verteton se ne daten e nenshkrimit te kesaj Kontrate ai zoteron kuotat qe do te transferohen sipas kesaj Kontrate, dhe ka te drejten per ti transferuar keto kuota dhe se nenshkrimi apo zbatimi i kesaj Kontrate nga Shitesi nuk vjen ne kundershtim me ligjet, Statutin, kontratat, marreveshjet apo dokumente te tjera ligjore, subjekt i te cilave eshte Shitesi.

3.2. Bleresi deklaron dhe verteton se ne daten e nenshkrimit te kesaj Kontrate Bleresi ka tagra te plota per te pranuar kuotat nga Shitesi sipas percaktimeve te kesaj Kontrate dhe se nenshkrimi apo zbatimi i kesaj Kontrate nga Bleresi nuk vjen ne kundershtim me ligjet, Statutin, kontratat, marreveshjet apo dokumente te tjera ligjore, subjekt i te cilave eshte Bleresi.

Neni 4 Transferimi i te drejtave mbi kuotat

4.I.Pronesia mbi kuotat e Shoqerise, objekt i kesaj Kontrate, kalon nga Shitesi te Bleresi menjehere me nenshkrimin e kesaj Kontrate dhe qe nga ky moment Bleresit i lind e drejta e regjistrimit te kesaj kontrate ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe Shitesi bie dakort per kete.

4.2. Menjehere me nenshkrimin e kesaj kontrates Bleresi behet ortak i vetem i Shoqerise duke zoteruar 100% te kapitalit te saj.

4.3. Me nenshkrimin e kesaj Kontrate, Bleresi gezon te gjitha te drejtat per te regjistruar pronesine mbi kuotat e zoteruara ne emer te tij ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit si dhe prane çdo institucioni tjeter shteteror sipas legjislacionit ne fuqi dhe per ndjekjen e kesaj procedure autorizon Z. Fabian Dici, mbajtes i letemjoftimit ID me nr. 028791732 dhe nr. Personal I61127049B.

Neni 5 Te ndryshme

5.1. Cdo kusht, klauzole apo parashikim i kesaj Kontrate do te jete i vlefshem pavaresisht kushteve, klauzolave apo parashikimeve te tjera dhe vlefshmeria e nje kushti, klauzole apo parashikimi nuk do te cenohet nga pavlefshmeria e nje kushti, klauzole apo parashikimi tjeter,

5.2. Kjo Kontrate do te interpretohet dhe zbatohet ne perputhje me dispozitat e Ligjit 990112008, te ndryshuar dhe Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.

5.3. Cdo konflikt qe ka lindur si pasoje apo lidhet me kete Kontrate do te zgjidhet ne marreveshje ndermjet Paleve, ne rast te kundert kompetente per zgjidhjen e konflikteve eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

5.4. Kjo Kontrate hartohet ne gjuhen Shqipe ne 4 (kater) origjinale.

Lexuar, pranuar e nenshkruar nga palet.

| SHITESI | BLERESI |
|---|---|
| Joana Karaj | Astrit Xhebrahimi |